

Syllabusi i lëndës

Lënda: AKAIID I, *Besimi në kushtet e imanit.*

Programi i studimit: Studime Islame

Numri i ECTS kredive: 6

Statusi i lëndës: Obligative

Kodi i lëndës: 109

Fondi i orëve: 3+2

Viti akademik: 2015/2016

Semestri: III

Mësimdhënësi: Mr. Naim Tërnavë

Përshkrim i shkurtër i lëndës

Kjo lëndë përmban besimin si fenomen mbarënjëzorë dhe atë islam në veçanti. Nevoja e njeriut për kultivimin e besimit në shoqërinë bashkëkohore. Historia e besimit islam dhe fazat e zhvillimit të kësaj shkence. Besimit në Zot dhe argumentet e tij. Besimi në fat dhe fatalitet. Fenomeni në shpalljes, dhe institucioni pejgamberik. Besimi në muxhize\mrekulli, dallimi ndërmjet mrekullive pejgamberike dhe fenomeneve magjike.

Qëllimi i lëndës

Njohja e studentëve me njohuri bazë nga lëmi i Akaidit\Besimit Islam, mbi historikun, përkufizimet burimet dhe zhvillimin e tij, mbi parimet tradicionale të besimit islam siç janë besimin në Zot, melekë, libra, pejgamberët, në Ditën e Kiametit dhe në Kada dhe Kader. Zhvillimi i shkathtësive dhe aftësive për të analizuar të dhënat e ndryshme mbi besimin të cilat përfshin programi studimor në mënyrë që të mund të nxjerrin konkluzione për to. Fitimi dhe avancimi i sensit të kritikës në aspektin e vlerësimit të argumenteve bazuar në fakte përkatëse të teksteve themelore të besimit islam. Aftësimi për të shkruar ese apo për të diskutuar për to, në një stil të pastër dhe bindës të të shprehurit me gojë dhe me shkrim, tipare këto të një personi me një edukim liberal akademik. Prej leksioneve nga Akadi I të semestrit të parë presim që studenti pas përfundimit të këtij kursi do të përfitojë kulturë të përgjithshme mbi bazat e besimit islam, dhe dallimet që ekzistojnë ndërmjet sekteve të ndryshme ndaj çështjeve dytësore të besimit. Të kuptojë proceset e zhvillimit të besimit islam që nga formimi i tij e deri në ditët e sotme. T'i jepet mundësi studentit që në formë kritike duke nxitë debate, t'i kuptoj çështjet e përbashkëta ndërsektare dhe ato që i ndajnë. Të kuptojë se zhvillimi i studimit të besimit është në interes të ruajtjes së besimit tek individit dhe shoqëria, besim i cili ia kultivon njeriut humanizmin dhe e ngritë moralisht saqë edhe nëse mungon mbikëqyrja shoqërore, nuk do t'i mungojë individit kontributi të cilin duhet ta jep në shoqëri, prandaj

ky studim është në interes të shoqërisë, dhe duhet të zhvillohet dhe avancohet edhe më shumë.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të kursit, studenti do të jetë në gjendje të:

Të përshkruaj etapat e zhvillimit të akaidit – besimit islam.

Të krahasoj ndërmjet pikëpamjeve të ndryshme ndaj çështjeve të besimit të cilat i studion gjatë kursit.

Të diskutoj rreth këtyre çështjeve të besimit islam në bazë të argumenteve esenciale islame, duke qenë sa më objektiv në parashtrimin e tyre.

Të mbroj qëndrimet e sekteve akaidologjike ashtu siç i konceptojnë ithtarët e tyre.

Të prezantoj mendimin kritik ndaj secilës prej tyre, duke paraqitur atë më të vlefshmin.

Të jetë në gjendje që njohuritë e fituara t'i aplikoj në relacionet shoqërore në vendin tonë

Metodologjia e mësimdhënies:

- Ligjërata
- Analiza dhe diskutime interaktive
- Prezantime të projekteve grupore dhe individuale
- Prezantimi i audio dhe video materialeve

Përmbajtja e lëndës:

Java e parë: Hyrje, njohja me syllabusin, metoda, organizimi, kërkesat dhe vlerësimi. Njohuri të përgjithshme mbi besimin. Besimi si fenomen mbarnjerëzorë. Njeriu si qenie besimtare. Nevoja bashkëkohore e besimit dhe roli i tij në shoqëri. Fenomeni i ateizmit, faktorët ndikues të shfaqjes së tij. Historiku i akaidit, përkufizimet, dhe burimet e tij. Fazat e zhvillimit të shkencës së akaidit.

Debat rreth besimeve në vendin tonë

Literatura: Prof. dr. Bekir Topaloglu, *Hyrje në kelam*, përktheu: Mithat Hoxha, Prishtinë, 2002. f. 9- 43. (*Në vazhdim do të mjaftohemi vetëm me cekjen e faqeve të kësaj reference deri në literaturën tjetër.*.)

Java e dytë: Përkufizimi, tematika dhe qëllimi i shkencës së *Kelamit*. Burimet dhe specifikat e besimit islam

Bisedë interaktive, mbi shfaqjen e shkencës së *Kelamit*, dhe burimeve të besimit dhe dukurive të ndryshme në emër të besimit

Literatura: (f. 46-66).

Java e tretë: Konkluzionet, argumentet dhe metodat. Konkluzionet: Konkluzionet fetare, Konkluzionet racionale. Argumentet: Dija, argumenti, argumentimi.

Diskutim mbi argumentet dhe diturinë në tërësi.

Literatura: (f. 69-83).

Java e katërt: Metodat: Metoda fetare, metoda filozofike. Besimi te Allahu: Ekzistenca e Allahut. Besimi dhe njeriu. Rrymat mohuese. Problemi i mohimit.

Propozim për tema seminarike

Literatura: (f. 84-91). Po ashtu: Bekir Topaloglu dhe të tjerë, *Bazat e besimit në islam*, përktheu: Mithat Hoxha, Prishtinë, 2002, f. 33-46. (*Në vazhdim do të përdoret e njëjta literaturë prandaj do të ceket vetëm nr. i faqeve*).

Java e pestë: Argumentet që vërtetojnë ekzistencën e Allahut: Veçoritë e çështjes.

Argumentet mbi ekzistimin e Allahut: Argumeti; i natyrshmërisë, frymëzimit, krijesës dhe rregullsisë. Njëshmëria e Allahut. Feja e njëshmërisë. Llojet e njëshmërisë: Njëshmëria në besim. Njëshmëria në adhurim.

Bisedë interaktive rreth ekzistencës së Allahut dhe njëshmërisë adhuruese.

Literatura: (f. 48-71).

Java e gjashtë: : Llojet e politeizmit (*shirkut*). Politeizmi. Respekti i tepruar për krijesat. Njohja e të fshehtës. Pamëkatësi-*shefa-at*. Dyfytirësia dhe interesi. Atributet e Allahut: Qenia e të Larmadhëruarit dhe atributet e Tij (*Sifat*). Emrat e bukur të Allahut (*Esmaul husna*).

Bisedë mbi Emrat e bukur të Allahut dhe fshehtësia e tyre.

Literatura: (f. 71-96).

Java e shtatë: Atributet hyjnore: Atributet mohuese (*selbi*). Atributet pohuese (*thubuti*). Atributet praktike (*fi'li*). Shikimi i Allaut: Mundësia e shikimit të Allahut në këtë botë. Në Botën e Amshuar. Qëndrimet e *Ehli Sunetit* dhe *Mu'tezilëve* mbi shikimin e Allahut në këtë dhe Botën e Amshuar.

Testi i parë, studentët do të ndahen në dy grupe për mbajtjen e testit të parë.

Literatura: (f. 97-109).

Java e tetë: *Kaderi* dhe *Kadaja* (Përcaktimi dhe Vendimi, ose, Fati dhe Fataliteti). Vullneti i Allahut dhe vullneti i njeriut. E fshehta e Kaderit. Lloji njerëzorë dhe Kaderi. Pejgamberia (*Nubuvvat*). Dallimi i fjalës “pejgamber” dhe “profet”. Nevoja e njerëzimit për pejgamber.

Bisedë interaktive mbi Kaderin e Kadanë, dhe peygamberinë.

Literatura: (f. 109-125).

Java e nëntë: Fenomeni i shpalljes: Shpallja/Zbulesa (*Vahj*). Përkufizimi i shpalljes. Llojet e komunikimit hyjnor. Mundësia e komunikimit hyjnor. Peygamberi (*nebij*), dhe i dërguari (*resul*). Besimi në institucionin e peygamberisë. Idetë themelore të institucionit të peygamberisë. E vërteta historike e institucionit të peygamberisë. Domosdoshmëria e peygamberisë.

Diskutim rreth mbi komunikimin hyjnorë dhe paraqitjen e peygamberëve të rrejshëm në arenën ndërkombëtare dhe te ne.

Literatura: (f. 125-132).

Java e dhjetë: Mrekullitë, argumentet perceptuese të peygamberisë. Mrekullitë përceptimore, informative dhe njohëse. Besimi te peygamberët. Numri i peygamberëve. Veçoritë e tyre.

Debat rreth krahasimit të mrekullive të peygamberëve dhe magjisë.

Literatura: (f. 133-145).

Java e njëmbëdhjetë: Nivelet dhe detyrat e peygamberëve. Dallimi ndërmjet peygamberëve, evliave dhe gjenive. Dyshimet rreth misionit peygamberik.

Diskutim mbi peygamberinë dhe gjenialitetin.

Literatura: (f. 145-149), dhe el-Buti. Muhammed Said Ramadan, *Të vërtetat e patundshme të besimit islam*, përktheu: Abdurrahman Asllani, Ibadete Imeri, Tetovë, 2004. f. 236-238.

Java e dymbëdhjetë: Besimi te peygamberia e Mahamedit a.s. Argumentet e peygamberisë së Muhamedit s.a.v.s. Paralajmërimi i ardhjes së Muhamedit s.a.v.s. në librat hyjnorë të mëparshëm.

Diskutim mbi argumenteve

Literatura: Prof. Bekir Topaloglu dhe të tjerë, *Bazat e besimit në islam*, f. 149-161.

Java e trembëdhjetë: Muxhizet (Mrekullitë), besimi i detyrueshëm. Rëndësia e muxhizeve. Dallimi ndërmjet; muxhizes, *kerames*, dhe *irhasit*. Qëndrimi shkencorë ndaj muxhizes.

Debat rreth muxhizeve dhe shkencës.

Literatura: el-Buti. Muhammed Said Ramadan, *Të vërtetat e patundshme të besimit islam*, f. 214-214).

Java e katërbëdhjetë: Kur'ani fisnik - muxhize e përhershme. Muxhizet e dukshme në Kur'anin fisnik.

Diskutime mbi racionalizmi e tepruar të Mu'tezilëve.

Literatura: (f. 218-230).

Java e pesëmbëdhjetë: Qëndrime të ndryshme rreth muxhizes. Dyshimet mbi muxhizet.

Testi përfundimtarë, studentët do të ndahen në dy grupe për mbajtjen e këtij testi

Literatura: (f. 230-235).

Kriteriumi dhe komponentët e vlerësimit:

Pjesëmarrje dhe angazhimi në ligjeratë 10%

Punimi seminarik 20%

Testi intermedier 30%

Provimi final 40%

Total 100%

Literatura obliguese:

1. Dr. Bekir Topaloglu, *Hyrje në kelam*, përktheu: Mithat Hoxha, Prishtinë, 2002.

Literatura shtesë dhe bibliografia:

1. Veliu, dr. Galip; “Zoti në metafizikë, shkencë, Kur'an”, Gostivar, 1998

2. Topaloglu, Bekir; “*Ekzistenca e Zotit*”, përkth. Mit'hat Hoxha, Prishtinë, 2002

3. Kardavi, dr. Jusuf; “*Të ekzistuarit e Allahut*”, Gostivar, 2001